

VENDIM
Nr.475, datë 6.5.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “SOTIRË 1” DHE “SOTIRË 2”, DHE
MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I
JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Sotirë 1” dhe “Sotirë 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 pikëve shoqërisë “Shushica”, sh.p.k., për rezultatin teknik e financiar, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Sotirë 1” dhe “Sotirë 2”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha